Project: Date ....../....../ 17

Protokoll Nr. 8.

Ky protokoll mbahet sot më datë 27.8.2025 - ora $10^{00}$ në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Divjakë kati i dytë në godinën e Bashkisë për zhvillimin e mbledhjes së radhës për muajin gusht 2025.

Në mbledhje morën pjesë këshilltarët:

Lin Biti, Njazi Bollo, Alketa Çaraku,
Juljan Vrapi, Elona Stambolliu,
Shpetim Sheshi, Elmerina Sina, Xhorxhi Jerati
Indrit Zgjana, Ajete Mebelli
Gejmnt Apolli, Mishel Vedhie, Sahit Ibrahimaj
Sefet Kapo, Sokol Koloshi,
Antonela Gjini, Adelajda Çuli.

Meqenëse u plotësua kuorumi i nr të këshilltarëve gjithsej 17 këshilltarë, Kryetarja zj Lin Biti kaloi tek Rendi i ditës.

1. Miratimi i Rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dt. 25.7.2025.
3. Informacion mbi zbatimin e VKB për muajin Korrik.
4. Projekt vendim për miratimin e fëmijëve që do të trajtohen nga fondi i kushtëz 6% për muajin Korrik.
5. Projekt vendim për miratimin e Planit Social 2025-202[illegible]
6. Projekt vendim për mirat. e Planit [illegible] 2025-2030
7. Projekt vendim për miratimin e Planit lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve 2025-2029.
8. Projekt vendim për miratimin e Planit të mbarë shtimit të pyjeve 2025-2030 për Bashkinë Divjakë.
9. Projekt vendim për miratimin e Planit vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030.
10. Projekt vendim: Për përditësimin e pasurisë me nr 115 të listës së inventarit të pronave të kaluara në pronësi/përdorim të Bashkisë Divjakë me VKM nr 499 dt. 19.07.2006.
11. Projekt vendim për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa regjistruar në ASHK, pranë Drejtorisë vendore Kushtet për lidhjen e kontratave pranë noterit.
12. Projekt vendim për miratimin e Marrëveshjes për

Project: Date ...... / ...... / ...........

krijimin e personit juridik si subjekt i kombëtarë [illegible] të për bashkësitë Njësive të Vet.Vendore dhe Këshillit të Ministrave të RSH, për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore, akademia e trajnimit të Njës. Vet.Qev vendore në RSH (TALGA)

13. Zgjedhje e Zv. Kryetarit të Këshillit Bashkiak.

1. Pika e parë e rendit të ditës
- Miratimi i rendit të ditës.

Kryetarja znj. Ain Bili i drejtohet këshilltarëve: A keni pyetje, shtesa apo diskutime për rendin e ditës?

Relatoi këshilltarja znj. Elmerina Sina, duke propozuar shtesë në rendin e ditës "Informacion nga Drejtoria e financës dhe Buxhetit për Aktivet e Bashkisë Divjakë.

Pyetje të tjera s'ka, shtesa të tjera s'ka diskutime për këtë shtesë nuk ka.

Hidhet në votim pika e parë e rendit të ditës si bashku me shtesën e propozuar ku ky informacion do të rendittet në pikën e katërmbëdhjetë dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

2. Pika e dytë e rendit të ditës
Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes datë 25.7.025.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e dytë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

3. Pika e tretë e rendit të ditës
- Informacion mbi zbatimin e VKB për m. Korrik.
Pyetje s'ka diskutime s'ka.
Kryetarja i jep fjalën Kryetarëve të komisioneve për raportet e shqyrtimit të projekt vendimeve.
Lexon raportin e Komisionit të ekonomisë dhe financave z. Gajoit Ngolli duke u shprehur se Komisioni në mbledhjen e tij ponë shqyrton Projektvendimet vendosi: 6 kolo[illegible] për miratim projekt vendimin për [illegible] e [illegible] që datë

trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për Bllok-ndihmen për muajin Korrik 2025. Të kalojë për miratim projektvendimin për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit juridik, si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis AKVSV, E Ministrore, dhe TAGA.

Lexon raportin e Komisionit të bujqësisë, pyjeve, mbrojtjes së mjedisit, kryetari i Komisionit z. Shpëtim Shkëmbi duke u shprehur se Komisioni pasi shqyrtoi Projekt vendimin vendosi që: Të kalojë për miratim projekt vendimin për miratimin e Planit Lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve 2025-2029, si dhe projektvendimin për miratimin e planit të mbareshtimit të pyjeve 2025-2035.

Kryetarja i jep fjalën për leximin e raportit të Komisionit të arsimit, rinisë, kulturës, sporteve dhe turizmit kryetares së komisionit znj. Elmerina Shima e cila shprehet se komisioni pasi shqyrtoi projektvendimin vendosi që të kalojë për miratim projekt vendimin mbi Planin e Arsimit parauniversitar 2025-2030.

Raportin për komisionin e shëndetësisë, mirëqenies sociale dhe barazisë gjinore e lexon kryetarja e komisionit znj. Alketa Çomaku, ku shprehet se Komisioni pasi shqyrtoi projektvendimet vendosi të kalojë për miratim dhe përkatësisht projektvendimin për miratimin e planit social 2025-2028 dhe projektvendimin për planin vendor për barazinë gjinore 2025-2030.

Pas raporteve kalohet tek:

4. Pika e katërt e rendit të ditës

-Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për bllok ndihmen për muajin Korrik 2025.

Kryetarja i jep fjalën për relatim përgjegjësit të sektorit të ndihmës ekonomike z. Xhelio Muço i cili shprehet se për muajin Korrik 2025 dolin nga sistemi i pikëzimit pa pikët e mjaftueshme dhe që kanë aplikuar, pasi është bërë dhe verifikimi në familje 15 familje me një fond prej 72,891 lekë, ku i propozoj këshilltarëve që këto familje të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri 6% të fondit të kushtëzuar.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e katërt e rendit të ditës
dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër
dhe asnjë votë abstenim.

5. Pika e pestë e rendit të ditës.
- Për miratimin e Planit social 2025-2028 për
Bashkinë Divjakë

Kryetarja zj. Xhina Biti ia jep fjalën për relatim
z. Xediq Muco, i cili i propozon këshilltarëve që
ta miratojnë këtë plan sepse në të janë eviden-
tuar të gjitha proceset e vlerësimit të nevojave
për shërbime të kujdesit shëndetësor e shoqëror.
Vlerësimi i nevojave identifikoi grupet kryesore
më në nevojë për shërbime të cilat i përmendi
me radhë: pjesëtar të familjeve përfituese të ndihmës
ekonomike, persona me aftësi të kufizuar, fëmijët në
nevojë për mbrojtje, komuniteti rom dhe egjiptian,
viktima të dhunës në familje, të moshuar në
nevojë për përkujdesje, viktima të trafikimit etj.
Për të përmbushur vizionin dhe misionin e Planit
social 2025-2028 në planin e veprimit të tij është
përcaktuar arritja e 3 qëllimeve: 1- Përmirësimi i
kushteve për zhvillimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit
shoqëror, 2- Përmirësimi i shërbimeve sociale, 3- Zhvil-
limi i komponentit parandalues i shërbimeve të kujd. shoq.
Pyetje nga këshilltarët s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e pestë e rendit të ditës dhe
votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe
asnjë votë abstenim.

6. Pika e gjashtë e rendit të ditës
- Për miratimin e "Planit të arsimit parauniversitar 2025-2030.

Relaton specialistja e arsimit në Bashki zj. Neraida
Adoni duke vënë në dukje përmbajtjen e këtij
Plani, hartimin e tij nga grupi i punës i ngritur me
urdhër të kryetarit, qëllimin dhe misionin e Planit
objektivat strategjike ku përmendi përmirësimin e
menaxhimit dhe administrimit arsimor përmes trajni-
meve, digjitalizimit dhe strukturave ndër institucionale.
- Përmirësimi i infrastrukturës shkollore dhe parashkol-
lore duke siguruar kushte higjieno-sanitare etj.

gjithashtu në këtë plan shprehet specialistja e përfshirë dhe rekomandimet që dolën nga procesi i konsultimit publik si: Rikonstruksioni i fushave sportive, vendosja e kamerave të sigurisë në institucionet arsimore, përmirësimi i palestrave ekzistuese ndriçimi i tyre, ndërtimi i dhomave të veshjes e zhveshjes, dushe etj, ndërtimi ose rikonstruksioni i kopshteve që aktualisht janë mangut megjithëse dhe kërkesë për fonde nga donator me qëllim uljen e kostove duke paguar qeratë mujore.

Sekretarja: A keni pyetje apo diskutime për pikën e gjashtë të rendit të ditës?

Pyetje z. Shpëtim Shehu: A është bërë ndonjë plan një vlerësim mbi ecurinë e nr të nxënësve në shkolla si është kjo ecuri në rritje apo në ulje sipas zonave apo sipas shkollave.
Në këtë plan a është planifikuar ndërtimi i shkollave apo rikonstruksioni i tyre nëpërmjet këtij studimi?

Përgjigjet znj. Lindi Bici si drejtore e shkollës 9 vjeçare në Drinjakë duke u shprehur se nr i nxënësve në shkolla po ulet nga dita në ditë. Kemi bërë një studim dhe rezulton se nr i fëmijëve po reduktohen.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e gjashtë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

7. Pika e shtatë e rendit të ditës
- Për miratimin e Planit Lokal të menaxhimit të integruar të mbetjeve 2025-2029.

Relaton znj. Xhenina Aleçi, Përgjegjëse e financës pranë Agjensisë së Shërbimeve Komunale, dhe shprehet duke prezantuar qëllimin e planit, vizionin e tij, objektivat specifike të planit ku përfshihen: rritja e eficencës në grumbullimin e të ardhurave sipas sistemit fiskal aktual duke rritur mbulimin e shpenzimeve nga të ardhurat e marra nga tarifat e pastrimit.
rehabilitimi mjedisor dhe pyllëzimi i ish vendepozitimeve duke siguruar se do ndikoni negativisht në mjedise.

TRETAPRILL KIADINJAK

Project: Date ...... / ...... / ..........

Minimizimi i mbetjeve nëpërmjet nxitjes dhe promovimit të kompostimit, të rritet roli në aktivitet bujqësor. Shtrirja më e gjerë e sistemit të diferencuar të grumbu-llimit të mbetjeve nëpërmjet ndarjes në burim, ndërtimi i një stacioni transferimi të mbetjeve dhe stacionere të kompostimit, përshtatja e skemës së menaxhimit të mbetjeve urbane në zonën e plazhit duke ulur kostot. Efiçentimi i sistemit fiskal për shërbimin e menaxhimit të mbetjeve me aplikimin e tarifës progre-sive duke respektuar parimin ndotësi paguan.

Kryetarja zj. Din Bili: A kemi pyetje?

Pyetje z. Sahit Ibrahimaj: Kur do të vendosen koshat e mbeturinave në lagjen e Kërçojës në Jshotin Spiolet? Ajo që ble koshe sivjet se kjo problematikë ka që në vitin 2024?

Përgjigjet Kryetari i Bashkisë duke sqaruar se kemi patur disa problematika në blerjen e tyre. ku na ofruan koshe jashtë standardeve dhe vendosim kritere verifikimi në procedurat e tenderimeve.

Pyetje z. Xhorxhi Kruti: Një problematikë e madhe është dhe grumbullimi i plastikave të zeza, duhet të planifikohet vendi për grumbullimin e tyre.

z. Sahit Ibrahimaj propozon që të caktohet vendi për hedhjen e mobiljeve të vjetra, i mbetjeve të gjelbërta të cilat janë bërë pengesë për hedhjen e mbetjeve të tjera në kosha.

Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka.

Hidhet në votim pika e shtatë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vota pro, asnjë vot kundër dhe asnjë votë abstenim.

8. Pika e tetë e rendit të ditës

Për miratimin e planit të mbarështimit të pyjeve 2025-2035.

Relator z. Andi Bullari duke u shprehur mbi bazën ligjore ku është hartuar plani, qëllimi i planit mbi për mbarështimin e planit i cili përfshin, inventarizimin e fondit pyjor, masat e menaxhimit dhe mirëmbajtjes, hartën pyjore dhe ndarjen në zona funksionale, masat për zhvillimin ekonomik si dhe i propozoj këshilltarëve që të miratojnë këtë plan.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e tetë e rendit të ditës dhe votohet me 17 vote pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
9. Pika e nëntë e rendit të ditës
Për miratimin e Planit Vendor të veprimit për barazinë gjinore 2025-2030.
Relatori kordinatorja kundër dhunës në familje znj. Xxxxx gjini, ku shprehet mbi rëndësinë e planit, përmbajtjen e tij, bazën ligjore ku u mbështet grupi i punës, objektivat e këtij plani, qëllimi strategjik i tij dhe theksoi se ky plan 2025-2030 është hartuar për mes një procesi ndërveprues e gjithëpërfshirës në bashkëpunim dhe konsultim të gjerë me institucione publike dhe, i propozoi këshilltarëve që ta miratojnë.
Pyetje s'ka, diskutime s'ka.
Hidhet në votim pika e nëntë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.
10. Pika e dhjetë e rendit të ditës
Për përditësimin e pasurisë me nr 15 të listës si inventar të pronave të kaluara në pronësi/përdorim me VKM 464 dt. 18.7.06
Kryetarja znj. Dini Bitri i jep fjalën për relatim. Drejtorit të Dr. Pl. Zhv. Terr z. Ardit Jouko, i cili theksoi se në tabelën e inventarit është inventarizuar gabim në numrin e pasurisë, kjo pronë rezulton si pasuri me nr 630/12, nr ky që i korrespondon një pasurie tjetër e cila bie në një pozicion tjetër gjeografik. Në këto kushte Bashkia e kaltë pamundur të bëjë regjistrimin dhe certifikimin e kësaj prone, prandaj ka filluar procedurat për përditësimin e pronës me nr 15 të listës si inventarit dhe ju propozoj të miratoni këtë përditësim.
Pyetje z. Mishel Verdho: Ku ndodhet rruga në këtë hartë?
Përgjigjet z. Ardit Jouko duke bërë sqarimin e duhur.
Pyetje të tjera s'ka, diskutime s'ka
Hidhet në votim pika e dhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe

asnjë votë abstenim.

11. Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

- Për miratimin e përfundimit të procedurës së privatizimit të banesave të cilat kanë mbetur pa regjistruar në ASHK pranë Dr. Vend Dishnje për lidhjen e kontratave pranë noterit.

Relator z. Andi Bullari ku i propozon këshilltorëve që të miratojnë këtë procedurë privatizimi përveç 4 (katër) aplikanteve që janë në projekt zhvillimi 1. Ali Ymer Kolonjari, Aishe Nazif Kolonjari 3. Zarif Mehmet Hamzaj 4. Kadri Xhemal Shuka por edhe një familjeje aplikant z. Shefqet Veqaj i cili i dorëzoi dokumentacionin më dt. 26.08.2025. Banues në Grabjan.

Pyetje s'ka, diskutime s'ka

Hidhet në votim pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim, kjo me shtesën e propozuar nga Juristi Andi Bullari, nga 4 familje u miratuan listë me 5 familje aplikante.

12. Për miratimin e marrëveshjes për krijimin e personit

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

- Për miratimin e Marrëveshjes për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis N.V.S.V dhe K.M., për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore (TALGA)

Relator Juristi z. Andi Bullari, duke u shprehur mbi rëndësinë e lidhjes së kësaj Marrëveshje, qëllimin e saj, vizionin mbi kualifikimin profesional e të qëndrueshëm të nëpunësve civil dhe punonjësve të tjerë, janë përcaktuar objektivat dhe prioritetet e bashkisë në bashkëpunim me qeverinë.

Pyetje s'ka, diskutime për këtë pikë s'ka.

Hidhet në votim pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës dhe votohet me 17 votë pro, asnjë votë kundër dhe asnjë votë abstenim.

13. Zgjedhje e zv.kryetarit të Këshillit Bashkiak Dibër

- Propozimi i kandidatëve për zv.kryetar të Këshillit

z. Sulejman Sheshi propozoi për kandidat për

Project: Date ...... / ...... / ..........

zv. kryetar këshilltorin z. Indrit Zgjong nga subjekti i Partisë Socialiste
propozime të tjera për kandidat për zëvendës kryetar të Këshillit nuk ka.
Kryetarja znj. Alin Biti: Fton komisionin e votimit për përgatitjen e procedurave të votimit. Komisioni i votimit përbëhet nga Gazmend Agolli kryetar Adelajda Suli zv/kryetar dhe Juljan Urapi sekretar.
z. Sahit Ibrahimaj: Nuk votoj pa kartë identiteti, ashtu si nuk votova edhe për Kryetaren e Këshillit.
Replikon Kryetarja e Këshillit duke iu përgjigjur se në radhë të parë jemi persona publik, kemi mandatin e këshilltarit dhe në dosje të arkivimit ndodhet fotokopje e kartës së identitetit.
Nga komisioni u plotësuan fletët e votimit me emrin e kandidatit për zëvendës kryetar z. Indrit Zgjong, këshilltarët votuan në mënyrë të fshehtë dhe pas votimit kryetari i komisionit të votimit z. Gazmend Agolli, lexoi Procesverbalin për votimin dhe numërimin e votave për zv/kryetar të KB. Në procesin e votimit për zv/kryetar të KB votimi u kryen për kandidatin Indrit Xhafer Zgjong Nga verifikimi i fletëve të votimit rezultoi se:
Në votim morën pjesë 16 (gjashtëmbëdhjetë) këshilltarë
Fletë votimi të gjetura në kuti 16.
Fletë votimi të vlefshme 16 gjashtëmbëdhjetë.
Nga procesi i numërimit të votave për kandidatin për zv/kryetar të KB rezultoi se z. Indrit Xhafer Zgjong ka marrë 16 vota, u shpallet zëvendës-kryetar i Këshillit të Bashkisë Divjakë.
14. Pika e katërmbëdhjetë shtesë në rendin e ditës. Informacion për Aktivet e Bashkisë Divjakë.
Kryetarja znj. Alin Biti i jep fjalën për këtë informacion, z. Petrit Baskau, Drejtorit të Financës.
Informon këshilltarët mbi identifikimin sasior, fizik dhe cilësor të grup aktiveve të Bashkisë si objekte administrative, arsimore, shëndetësore, sociale

rrugë, sheshe, toka, troje, pyje, terene sportive sisteme ujitje dhe kullimi, kanalizime vetkime terenesh.
Mjete transporti, mjete pune dhe mjete motorike.
Bashkia administron 2496 prona nga të cilat 2025 prona janë në pronësi dhe 471 prona janë në përdorim të cilat i kanë kaluar nëpërmjet 8-të VKM të ndryshme që përfshijnë ndërtesa rrugë, sheshe, pyje, terene toka e sisteme ujitje.
Në mbyllje të vitit ushtrimor shprehet që, të v. 2024 Bashkia Divjakë paraqitet një situat ekonomike të aktiveve: Toka troje terene 11.805.771 lekë, Ndërtesa 1.218.842.678 lekë, Rrugë rrjete ujore 4.286842.618, Instalime teknike 85206103 lekë, Mjete motorike 110346862 lekë dhe inventar ekonomik 58385865 lekë.
Totali i aktiveve në vlerë arrin 5820633071 lekë.
Pyetje z. Sahit Ibrahimaj: Godina e Urban-Lab është e përfshirë në këto 2496 prona?
Përgjigjet z. Petrit Zosko: Jo, nuk kemi dokumente për atë dhe kemi vetëm tokën në pronësi, godinën jo.
z. Sahit Ibrahimaj: Përderisa nuk është me vlerë kontabël si godinë, përse e kemi dhënë në përdorim me qira me kontratë 2 vjeçare?
Në mbledhjen tjetër kërkoj informacion se si sqarohen këto objekte kur nuk kanë dokumentacion. Pyetje dhe diskutime të tjera s'ka.
Kryetarja znj. Diana Bita kalon në zërin të tjera.
znj. Alketa Conaku: Problematika kryesore është se mungon uji në Q.Sh. 3-Urat Grabjan. Duhet në mënyrë emergjente furnizimi me ujë i Q.Sh.
Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.
Po kemi të drejtë, jemi duke punuar që të eleminojmë këtë problematikë, si në fshatin 3-Urat por edhe në Grabjan.
z. Sahit Ibrahimaj: Ujësjellësi Grabjan-Mizë ka ndikuar në prishjen e rrugës, kur do të rregullohet rruga? Janë bërë shumë dëmtime dhe firma duhet të rregullojë patjetër rrugën që ka dëmtuar. → ka.

Project: Date ...... /...... / ...........

→ Përgjigjet Kryetari i Bashkisë z. Josif Gorrea.
z. Gjeto Mebelli ngre problematik & pro
drejtohet rrugë një mjeted e rëndë të firmës
Kryetari sqaron Këshilltarët për këto proble
matika.
Tjetër e diskutime të tjera nga këshilltarët
s'ka.
Kryetarja e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Kryetarja e Këshillit
Leni Beti

Sekretari i KB
Miniore Jollomaj

Maze Ballë

Sokol Katoshi

Xhoxhi Kruti

Mishel Verdhe

Gopard Agolli

Sajjan Vrapi

Elona Stamballiu

Gjeto Mebelli

Alketa Çaulli

Antoela Gjini

Elmerina Gjini

Adelajda Guli

Imirit Fejona